



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 953/ 7 prot.

Datë 24/04/2025

V E N D I M

Nr. 561/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24/04/2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-37939-02-12-2025, me objekt: “*BLERJE HIPOKLORIT NATRIUMI + REAGENTE KLOR*”, me fond limit 5.379.200 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Elbasan Sh.A.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-37939-02-12-2025, me objekt: “*BLERJE HIPOKLORIT NATRIUMI + REAGENTE KLOR*”, me fond limit 5.379.200 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Elbasan Sh.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I, dhe me adresë: *Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Elbasan Sh.A.
Adresa: Lagjja: “Brigada XVII Sulmuese”, Rruga: “Petraq Popa” Elbasan.

Persona të interesuar: Operatori ekonomik “2 AT” SHPK, me Nipt *K14019001H* me adresë: *Z. Kadastrale 1101, Nr. pasurie 262/82 Dishnicë, Korçë.*

Operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK, me Nipt *K22218003V* me adresë: *Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 10, Rruga dytësore, Vorë, Tiranë.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.02.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-37939-02-12-2025, me objekt: “BLERJE HIPOKLORIT NATRIUMI + REAGENTE KLOR”, me fond limit 5.379.200 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan Sh.A.

II.2. Në datë 25.03.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 01.04.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Albanian Distribution Chemicals” ShPK	0 leke	skualifikuar
2. “2 AT” ShPK	5.379.200 leke	kualifikuar
3. “ATLANTIK 3” ShPK	6.580.000 leke	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 08.04.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraparak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues shoqërinë “2 AT” ShPK.

II.5. Në datën 10.04.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5234, datë 10.04.2025, dhe me nr. 953/2025 prot, datë 11.04.2025 e operatorit ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” ShPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “2 AT” ShPK dhe ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK 3” ShPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 953/1, datë 11.04.2025 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albanian Distribution Chemicals” ShPK, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “2 AT” ShPK dhe ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK 3” ShPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “ATLANTIK 3” ShPK ka paraqitur argumenta lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albanian Distribution Chemicals” ShPK përsa i përket

skualifikimit të ofertës së tij sipas parashikimeve të nenit 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 953/2 prot., datë 15.04.2025.

II.8. Në datë 18.04.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 287/15, datë 17.04.2025 “Vendim”, protokolluar me tonën me nr. 953/3 prot, datë 18.04.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Albanian Distribution Chemicals” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“Ju si OE ankoheni lidhur me:

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK dhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Operatori ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK, në ankesën me nr. 953/2025 prot, datë 11.04.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK.

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

OE “2 AT” shpk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 (Bashkëlidhur dokumentacioni)

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OE “2 AT” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

2.3.6. Çertifikate/Leje/Licensë e lëshuar nga autoriteti kompetent për “Transport lënde të rrezikshme” (ADR) e shoqëruar detyrimisht me Leje të Qarkullimit të automjetit special në pronësi ose me Kontratë Qiraje (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme për gjatë gjithë procedurës së prokurimit, për automjetin special, që do të shërbejë për transportin e kimikatis Hipoklorit natriumi.

- Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura bazuar në skedat teknike të pajisjeve dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.”.

OE “2 AT” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” ShPK pretendon se oferta e operatorit ekonomik “2 AT” ShPK duhet të skualifikohet, pasi është ofertë anomalisht e ulët.

Në bazë të VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” Neni 82, Pika 4, citojmë: “Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur, atëherë vlera prej 7.283.333 duke zbritur 25% shkon 5.462.499,75. OE i shpallur fitues paraparak ka paraqitur një ofertë poshtë kësaj vlere që është 5.379.200.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave vlerëson si të drejtë pretendimin e OE ankimues. Pas përllogartitjes së kryer rezulton që oferta e OE “2 AT”shpk është anomalisht e ulët.

Gjithashtu kriteret për të cilat operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, në ankesën me nr. 953/2025 prot, datë 11.04.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK.

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

OE “ATLANTIK 3” shpk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 (Bashkëlidhur dokumentacioni)

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,*
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

OE “ATLANTIK 3” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

2.3.6. Çertifikate/Leje/Licensë e lëshuar nga autoriteti kompetent për “Transport lënde të rrezikshme” (ADR) e shoqëruar detyrimisht me Leje të Qarkullimit të automjetit special në pronësi ose me Kontratë Qiraje (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme për gjatë gjithë procedurës së prokurimit, për automjetin special, që do të shërbejë për transportin e kimikateve Hipoklorit natriumi.

- Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura bazuar në skadat teknike të pajisjeve dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

OE “ATLANTIK 3” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

Për sa cituam më lart Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi se :

VENDOSI

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga “ALBANIAN DISTRIBUTION CHIMICALS”

Bashkëlidhur dokumentacioni përkatës.”.

II.9. Me shkresën nr. 720 prot, datë 17.04.2025, protokolluar me tonën me nr. 953/4 prot datë 22.04.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, shkresa nr. 287/15, datë 17.04.2025 “Vendim”, protokolluar me tonën me nr. 953/3 prot, datë 18.04.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Albanian Distribution Chemicals” ShPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“Ju si OE ankoheni lidhur me:

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK dhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Operatori ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK, në ankesën me nr. 953/2025 prot, datë 11.04.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK.

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

OE “2 AT” shpk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 (Bashkëlidhur dokumentacioni)

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OE “2 AT” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

2.3.6. Çertifikate/Leje/Licensë e lëshuar nga autoriteti kompetent për “Transport lënde të rrezikshme” (ADR) e shoqëruar detyrimisht me Leje të Qarkullimit të automjetit special në pronësi ose me Kontratë Qiraje (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme për gjatë gjithë procedurës së prokurimit, për automjetin special, që do të shërbejë për transportin e kimikatis Hipoklorit natriumi.

- Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura bazuar në skedat teknike të pajisjeve dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

OE “2 AT” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” ShPK pretendon se oferta e operatorit ekonomik “2 AT” ShPK duhet të skualifikohet, pasi është ofertë anomalisht e ulët.

Në bazë të VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” Neni 82, Pika 4, citojmë: “Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur, atëherë vlera prej 7.283.333 duke zbritur 25% shkon 5.462.499,75. OE i shpallur fitues paraprak ka paraqitur një ofertë poshtë kësaj vlere që është 5.379.200.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave vlerëson si të drejtë pretendimin e OE ankimues. Pas përlllogartitjes së kryer rezulton që oferta e OE “2 AT”shpk është anomalisht e ulët.

Gjithashtu kriteret për të cilat operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, në ankesën me nr. 953/2025 prot, datë 11.04.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK.

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

OE “ATLANTIK 3” shpk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 (Bashkëlidhur dokumentacioni)

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për fumizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OE “ATLANTIK 3” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

2.3.6. Çertifikate/Leje/Licensë e lëshuar nga autoriteti kompetent për “Transport lënde të rrezikshme” (ADR) e shoqëruar detyrimisht me Leje të Qarkullimit të automjetit special në pronësi ose me Kontratë Qiraje (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme për gjatë gjithë procedurës së prokurimit, për automjetin special, që do të shërbejë për transportin e kimikatis Hipoklorit natriumi.

- Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura bazuar në skedat teknike të pajisjeve dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.”.

OE “ATLANTIK 3” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

Për sa cituam më lart Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi se :

VENDOSI

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga “ALBANIAN DISTRIBUTION CHIMICALS”

Bashkëlidhur dokumentacioni përkatës.”.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga ana e operatorit ekonomik të interesuar “2 AT” SHPK në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar .

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, përsa i përket kundërshtimit të kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “2 AT” SHPK dhe të ofertës së operatorit ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK në këtë procedurë prokurimi Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se,

III.1.1. Në datën 13.02.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-37939-02-12-2025, me objekt: “BLERJE HIPOKLORIT NATRIUMI + REAGENTE KLOR”, me fond limit 5.379.200 leke pa TVSH,

zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan Sh.A.

III.1.2. Në datë 25.03.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Në datën 01.04.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

4. <i>“Albanian Distribution Chemicals” ShPK</i>	<i>0 leke</i>	<i>skualifikuar</i>
5. <i>“2 AT” ShPK</i>	<i>5.379.200 leke</i>	<i>kualifikuar</i>
6. <i>“ATLANTIK 3” ShPK</i>	<i>6.580.000 leke</i>	<i>kualifikuar</i>

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 08.04.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues shoqërinë *“2 AT” ShPK*.

III.1.5. Në datën 10.04.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5234, datë 10.04.2025, dhe me nr. 953/2025 prot, datë 11.04.2025 e operatorit ekonomik *“Albanian Distribution Chemicals” ShPK*, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik *“2 AT” ShPK* dhe ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik *“ATLANTIK 3” ShPK*, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 *“Veprimet paraprake”* të Ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 953/1, datë 11.04.2025 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *“Albanian Distribution Chemicals” ShPK*, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik *“2 AT” ShPK* dhe ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik *“ATLANTIK 3” ShPK*, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik *“ATLANTIK 3” ShPK* ka paraqitur argumenta lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *“Albanian Distribution Chemicals” ShPK* përse i përket skualifikimit të ofertës së tij sipas parashikimeve të nenit 113 të Ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 953/2 prot., datë 15.04.2025.

III.1.8. Në datë 18.04.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 287/15, datë 17.04.2025

“Vendim”, protokollluar me tonën me nr. 953/3 prot, datë 18.04.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Albanian Distribution Chemicals” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“Ju si OE ankoheni lidhur me:

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK dhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Operatori ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK, në ankesën me nr. 953/2025 prot, datë 11.04.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK.

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

OE “2 AT” shpk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 (Bashkëlidhur dokumentacioni)

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- e) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- f) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OE “2 AT” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

2.3.6. Çertifikate/Leje/Licensë e lëshuar nga autoriteti kompetent për “Transport lënde të rrezikshme” (ADR) e shoqëruar detyrimisht me Leje të Qarkullimit të automjetit special në pronësi ose me Kontratë Qiraje (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme për gjatë

gjithë procedurës së prokurimit, për automjetin special, që do të shërbejë për transportin e kimikatit Hipoklorit natriumi.

- Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura bazuar në skedat teknike të pajisjeve dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

OE “2 AT” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” ShPK pretendon se oferta e operatorit ekonomik “2 AT” ShPK duhet të skualifikohet, pasi është ofertë anomalisht e ulët.

Në bazë të VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” Neni 82, Pika 4, citojmë: “Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur, atëherë vlera prej 7.283.333 duke zbritur 25% shkon 5.462.499,75. OE i shpallur fitues paraparak ka paraqitur një ofertë poshtë kësaj vlere që është 5.379.200.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave vlerëson si të drejtë pretendimin e OE ankimues. Pas përllogartitjes së kryer rezulton që oferta e OE “2 AT”shpk është anomalisht e ulët.

Gjithashtu kriteret për të cilat operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, në ankesën me nr. 953/2025 prot, datë 11.04.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK.

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

OE “ATLANTIK 3” shpk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 (Bashkëlidhur dokumentacioni)

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për fumizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

e) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të

shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- f) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OE “ATLANTIK 3” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

2.3.6. Çertifikate/Leje/Licensë e lëshuar nga autoriteti kompetent për “Transport lënde të rrezikshme” (ADR) e shoqëruar detyrimisht me Leje të Qarkullimit të automjetit special në pronësi ose me Kontratë Qiraje (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme për gjatë gjithë procedurës së prokurimit, për automjetin special, që do të shërbejë për transportin e kimikateve Hipoklorit natriumi.

- Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura bazuar në skemat teknike të pajisjeve dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

OE “ATLANTIK 3” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

Për sa cituam më lart Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi se :

VENDOSI

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga “ALBANIAN DISTRIBUTION CHIMICALS”

Bashkëlidhur dokumentacioni përkatës.”.

III.1.9. Me shkresën nr. 720 prot, datë 17.04.2025, protokolluar me tonën me nr. 953/4 prot datë 22.04.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, shkresa nr. 287/15, datë 17.04.2025 “Vendim”, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Albanian Distribution Chemicals” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar pjesërisht ankesën e ankimesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“Ju si OE ankoheni lidhur me:

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK dhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Operatori ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK, në ankesën me nr. 953/2025 prot, datë 11.04.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK.

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

OE “2 AT” shpk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 (Bashkëlidhur dokumentacioni)

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- g) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- h) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OE “2 AT” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

2.3.6. Çertifikate/Leje/Licensë e lëshuar nga autoriteti kompetent për “Transport lënde të rrezikshme” (ADR) e shoqëruar detyrimisht me Leje të Qarkullimit të automjetit special në pronësi ose me Kontratë Qiraje (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme për gjatë gjithë procedurës së prokurimit, për automjetin special, që do të shërbejë për transportin e kimikativit Hipoklorit natriumi.

- Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura bazuar në skedat teknike të pajisjeve dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

OE “2 AT” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” ShPK pretendon se oferta e operatorit ekonomik “2 AT” ShPK duhet të skualifikohet, pasi është ofertë anomalisht e ulët.

Në bazë të VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” Neni 82, Pika 4, citojmë: “Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur, atëherë vlera prej 7.283.333 duke zbritur 25% shkon 5.462.499,75. OE i shpallur fitues paraprak ka paraqitur një ofertë poshtë kësaj vlere që është 5.379.200.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave vlerëson si të drejtë pretendimin e OE ankimues. Pas përlllogartitjes së kryer rezulton që oferta e OE “2 AT”shpk është anomalisht e ulët.

Gjithashtu kriteret për të cilat operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, në ankesën me nr. 953/2025 prot, datë 11.04.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “ATLANTIK 3” SHPK.

“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

OE “ATLANTIK 3” shpk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 (Bashkëlidhur dokumentacioni)

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- g) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- h) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OE “ATLANTIK 3” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

2.3.6. Çertifikate/Leje/Licensë e lëshuar nga autoriteti kompetent për “Transport lënde të rrezikshme” (ADR) e shoqëruar detyrimisht me Leje të Qarkullimit të automjetit special në pronësi ose me Kontratë Qiraje (ose huapërdorje) me akt-noterial, të vlefshme për gjatë

gjithë procedurës së prokurimit, për automjetin special, që do të shërbejë për transportin e kimikatit Hipoklorit natriumi.

- Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura bazuar në skedat teknike të pajisjeve dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.”.

OE “ATLANTIK 3” shpk ka paraqitur dokumentacion që përmbush kriterin e mësipërm (bashkëlidhur dokumentacioni).

Për sa cituam më lart Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi se :

VENDOSI

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga “ALBANIAN DISTRIBUTION CHIMICALS”

Bashkëlidhur dokumentacioni përkatës.”.

III.1.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga ana e operatorit ekonomik të interesuar “2 AT” SHPK në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III.1.11. Në nenin 109, pikat 1 “E drejta e ankimit” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit ose entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.12. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj në Sistemin Elektronik të Ankesave. Ankesa quhet e

pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.13. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.14. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP-së, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik.”.

III.1.15. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (*qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit*), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

Neni 109, pika 1 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe neni 94, pika 1, i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar kërkojnë shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t’u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.1.16. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe

pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërisht nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin, vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, Komisioni konstaton se operatori ekonomik ankimues “*Albania Distribution Chemicals*” ShPK është i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi, pasi nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe nuk ka plotësuar asnjë nga kriteret kualifikuese të përcaktuara në Shtojcën 8 “*FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të modifikuara të kësaj procedure, ndërkohë që ankimin me numër ankimi elektronik A/2025/5234, datë 10.04.2025 dhe me numër protokoll nr. 953/2025 prot, datë 11.04.2025, lidhur me vlerësimin e datës 01.04.2025, nuk ka kundërshtuar skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, por ka kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “2 AT” ShPK dhe të ofertës së operatorit ekonomik “*ATLANTIK 3*” ShPK, duke mos patur interes të ligjshëm, pasi edhe nëse do të pranoheshin këto pretendime operatori ekonomik ankimues “*Albania Distribution Chemicals*” ShPK do të vijonte të mbetej i skualifikuar në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Në lidhje me vendimarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës referuar shkresës nr. 287/15, datë 17.04.2025 “*Vendim*”, përsa i përket pikës 1 të dispozitivit të këtij vendimi, para shqyrtimit në themel të kësaj pike, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, në të cilin parashikohet se: “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përrjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e operatorit ekonomik ankimues “*Albanian Distribution Chemicals*” ShPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor rasti konkret Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjatë shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Referuar informacionit të autoriteti kontraktor dërguar me shkresën nr. 720 prot, datë 17.04.2025, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 953/4 prot datë 22.04.2025, si dhe ankesës së operatorit ekonomik ankimues rezulton, se Komisioni Shqyrtimit të Ankesës, pasi mori në trajtim ankesën e operatorit ekonomik ankimues “*Albanian Distribution Chemicals*” ShPK me shkresën nr. 287/15, datë 17.04.2025 “*Vendim*”

ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, ku në pjesën arsyetuese është shprehur si ë vijim: “Gjithashtu operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” ShPK pretendon se oferta e operatorit ekonomik “2 AT” ShPK duhet të skualifikohet, pasi është ofertë anomalisht e ulët.

Në bazë të VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” Neni 82, Pika 4, citojmë: “Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur, atëherë vlera prej 7.283.333 duke zbritur 25% shkon 5.462.499,75. OE i shpallur fitues paraprak ka paraqitur një ofertë poshtë kësaj vlere që është 5.379.200.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave vlerëson si të drejtë pretendimin e OE ankimues. Pas përlllogartitjes së kryer rezulton që oferta e OE “2 AT” shpk është anomalisht e ulët., ndërkohë që në pikën 1 të dispozitivit të këtij vendimi ka vendosur si në vijim: “1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga ‘ALBANIAN DISTRIBUTION CHIMICALS’.”.

III.2.1. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

Në nenin 109, pikat 1 “E drejta e ankimit” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

- “1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose

mosveprimet e autoritetit ose entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:*

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP-së, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik.”.

Në nenin 114 *“Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor”* pika 3 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se komisioni i shqyrtimit të ankesë në përfundim të shqyrtimit të saj ka të përcaktuar këto tagra në lidhje me vendimarrjen e tij: *“3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës.”.*

III.2.2. Në interpretim të sa më sipër KPP gjykon, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesë pranë autoriteti kontraktor në shqyrtimin e ankesës së operatori ekonomik ankimues *“Albanian Distribution Chemicals”* ShPK nuk ka respektuar përcaktimet e nenit 109, pika 1 i Ligjit 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar dhe përcaktimet e nenit 94, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, pasi referuar vlerësimit të Komisionit të Vlerëimit të Ofertave të datës 01.04.2025 oferta e operatori ekonomik ankimues *“Albania Distribution Chemicals”* ShPK është i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi, sepse nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe nuk ka plotësuar asnjë nga kriteret kualifikuese të përcaktuara në Shtojcën 8 *“FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”* të dokumentave të tenderit të modifikuara të kësaj procedure, ndërkohë që në ankimin me numër ankimi elektronik A/2025/5234, datë 10.04.2025 dhe me numër protokoli nr. 953/2025 prot, datë 11.04.2025, lidhur me vlerësimin e datës 01.04.2025, nuk ka kundërshtuar skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, por ka kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik *“2 AT”* ShPK dhe të ofertës së operatorit ekonomik *“ATLANTIK 3”* ShPK, duke mos patur interes të ligjshëm, pasi edhe nëse do të pranoheshin këto pretendime operatori ekonomik ankimues *“Albania Distribution Chemicals”* ShPK do të vijonte të mbetej i skualifikuar në këtë procedurë prokurimi, pra nga sa më sipër marrja në shqyrtimi e këtyre pretendimeve të ankimuesit nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës bie në kontradiktë dhe ndesh me qëllimet e LPP siç është rritja e efikasitetit dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, si dhe të sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Pra nga sa më sipër rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka ndjekur hapat proceduralë të parashikuar në nenit 109, pika 1 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe përcaktimet e nenit 94, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, edhe pse e ka patur këtë mundësi, përse i përket legjitimit të pretendimeve të parashtruara në ankesën e operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” ShPK, kur ndërkohë ky operator ekonomik është i skualifikuar dhe njëkohësisht nuk ngre pretendime për të kundërshtuar skualifikimin e tij.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar KPP gjykon se ligjvënësi ka përcaktuar një procedurë të caktuar për tu ndjekur nga ana e autoriteteve kontraktore, ku veprimi procedural i KSHA-së në rastin konkret është në kundërshtim me përcaktimet e nenit 109, pika 1 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe përcaktimet e nenit 94, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. KPP e gjykon, të gabuar si në zbatimin ashtu dhe interpretimin e ligjit në rastin konkret nga ana e autoritetit kontraktor, pasi në respektim të dispozitave të mësipërcituara sikundër rezulton, nga faktet e parashtruara më sipër, autoriteti kontraktor nuk ka respektuar hapat proceduralë të parashikuar nga ligji, duke ndërmarrë vendime përtej parashikimeve ligjore. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se pika 1 e dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës referuar shkresës nr. 287/15, datë 17.04.2025 “Vendim”, në lidhje me pranimin pjesërisht të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” ShPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ofertues “2 AT” ShPK në këtë procedurë prokurimi do të konsiderohen si akt absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 108 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet se: “Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest).

Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (*domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik*), gjykon se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facie të një akti administrativ pjesërisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë

23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, konstaton se pika 1 e dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës referuar shkresës nr. 287/15, datë 17.04.2025 “Vendim”, në lidhje me në lidhje me pranimin pjesërisht të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” ShPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ofertues “2 AT” ShPK është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A. Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA në të cilën parashikohet se: “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.*”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, pika 1 e dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës referuar shkresës nr. 287/15, datë 17.04.2025 “Vendim” cënon në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenon edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se: “*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin.*”.

Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese Inter Allia në vendimin 15/2010 ka theksuar se “parimi i shtetit të së drejtës” i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për atë që sa i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore”.

Sa më sipër, K.P.P. konstaton, se pika 1 e dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës referuar shkresës nr. 287/15, datë 17.04.2025 “Vendim” është në kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon LPP, ndaj ky vendim duhet të anulohet si vendim i dalë në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Albania Distribution Chemicals*” ShPK në procedurën e prokurimit “*E hapur*”, me Nr. REF-37939-02-12-2025, me objekt: “*BLERJE HIPOKLORIT NATRIUMI + REAGENTE KLOR*”, me fond limit 5.379.200 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 25.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan Sh.A..
 2. Të konstatojë absolutisht të pavlefshëm pikën 1 e dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës referuar shkresës nr. 287/15, datë 17.04.2025 “Vendim” për pranimin pjesërisht të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “*Albania Distribution Chemicals*” ShPK, të marrë në kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Albania Distribution Chemicals*” ShPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

